



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

Nr. 143 Prot.

Tiranë, më 30.01 2018

**VENDIM Nr. 12, datë 18.01.2018**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), VKM Nr. 725, datë 21.05.2008 "Për përbërjen, funksionimin, kompetencat dhe mënyrën e shpërblimit të anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë" (i ndryshuar), Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë në mbledhjen Nr.1, datë 18.01.2018, pasi shqyrtoi Konceptin e sondazheve arkeologjike, për zonën e projektit "*Godinë banimi dhe shërbimesh 1-6 kate me 1 kat nëntokë*", me vendndodhje në rrugën "*Spiro Puteci*", në zonën arkeologjike "*B*" të qytetit të Durrësit - subjekti "INRA KONSTRKSION" sh.p.k., paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "A.K.e R." sh.p.k.,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë Konceptin e sondazheve arkeologjike, për zonën e projektit "*Godinë banimi dhe shërbimesh 1-6 kate me 1 kat nëntokë*", me vendndodhje në rrugën "*Spiro Puteci*", në zonën arkeologjike "*B*" të qytetit të Durrësit - subjekti "INRA KONSTRKSION" sh.p.k., paraqitur nga shoqëri e licencuar në arkeologji "A.K.e R." sh.p.k.
2. Subjekti "INRA KONSTRKSION" sh.p.k. duhet të lidhë paraprakisht akt-marrëveshje tre palëshe me shoqëri të licencuar në arkeologji, e cila do të realizojë sondazhet arkeologjike, si dhe Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik, e cila do të mbikëqyrë këtë shoqëri. Raporti i tyre do të paraqitet në KKA e radhës.
3. Investitori "INRA KONSTRKSION" sh.p.k duhet të derdhë detyrimet tatimore për mbikëqyrjen e realizuar nga ASHA, sipas tarifave të miratuara me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10.2015 dhe përcaktimeve përkatëse të akt-marrëveshjes tre palëshe.
4. Investitori "INRA KONSTRKSION" sh.p.k. si dhe shoqëria e licencuar në arkeologji, e cila do të kryejë sondazhet arkeologjike, në mbështetje të Ligjit Nr. 9048, datë 07.04.2003, "Për Trashëgiminë Kulturore" (i ndryshuar), Rregullores "Mbi kriteret e ushtrimit të profesionit të arkeologut" dhe akt-marrëveshjes tre palëshe të sipërcituar, janë të detyruar të marrin të gjitha masat për sigurimin dhe ruajtjen e kantierit, si dhe ruajtjen e strukturave arkeologjike, të cilat

Adresa: Rruga "Aleksandër Moisiu", Nr. 76, Tiranë

Tel: ++355 04 45 35 855

email: [sekretaria.kka@asha.gov.al](mailto:sekretaria.kka@asha.gov.al)

Website: [asha.gov.al](http://asha.gov.al)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E KULTURES**  
KËSHILLI KOMBËTAR I ARKEOLOGJISË

mund të zbulohen gjatë kryerjes së sondazheve, deri në vendimmarrjen përfundimtare të KKA, në lidhje me to.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
6. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.

**KRYETAR**  
**MIRELA KUMBARO FURXHI**  
**MINISTRE**



**SEKRETAR I KKA**

**RUDINA ZOTO**